



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

**LLOGARIDHËNIA DHE NDIHMA
PËR TË PËRMIRËSUAR POLITIKAT PUBLIKE
KOMISIONI PËR MBIKËQYRJE
TË FINANCAVE PUBLIKE**

Prishtinë, korrik 2010

www.kipred.net

INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

**LLOGARIDHËNIA DHE NDIHMA
PËR TË PËRMIRËSUAR POLITIKAT PUBLIKE
KOMISIONI PËR MBIKËQYRJE
TË FINANCAVE PUBLIKE**

Prishtinë, korrik 2010

Ky projekt është përkrahur nga Qeveria Britanike

Përgatitur nga: Anthony Staddon

Të drejtat e autorit © 2010 nga KIPRED. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në ndonjë sistem nxjerrjeje, të transmetohet, në çfarëdo forma ose përmes çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjim, regjistrim ose tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga publikuese. Ju lutem kontaktoni info@kipred.net ose +381 38 227778.

Qëndrimet e paraqitura në këtë dokument nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e donatorit

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Rexhep Mala, 5A, Kati II
10 000 Prishtinë, Kosovë
Telefon dhe Fax: +381 38 227 778
www.kipred.net

PËRMBAJTJA

I.	MIRËNJOHJE	4
II.	LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE	5
III	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	6
IV.	PËRMBLEDHJA E REKOMANDIMEVE	8
V.	PROGRAMI.....	11
VI.	HISTORIKU DHE KONTEKSTI.....	11
VII.	ZINXHIRI I LLOGARIDHËNIES BRENDIA KOSOVËS	12
A.	Vizioni	12
B.	Disa probleme.....	12
VIII.	INSTITUCIONI SUPREM I AUDITIMIT – ZYRA E AUDITORIT GJENERAL DHE ZYRA E AUDITIMIT TË KOSOVËS.....	13
A.	Resurset	14
IX.	KOMISIONI PËR MBIKËQYRJEN E FINANCAVE PUBLIKE.....	16
A.	Marrëdhënia në mes të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa	16
B.	Një komision partiak.....	19
C.	Respektimi i dallimeve në mes të politikës dhe zbatimit të politikës	20
D.	Marrja përsipër e hetimeve.....	22
E.	Reagimi i Qeverisë ndaj raporteve të auditimit	22
F.	Matja e Performancës	24
G.	Stafi dhe Ndërtesat e KMFP-së.....	26
IX.	KONKLuzion: NDËRTIMI I KULTURËS SË LLOGARIDHËNIES.....	29
ANEKS A		31
Mandati i Komisionit për Mbiqëqyrjen e Financave Publike		31
Mandati i Komisionit për Buxhet dhe Financa		32
BIBLIOGRAFIA.....		33

I. MIRËNJOHJE

Ky raport është përgatitur si pjesë e iniciativës për të zgjeruar funksionimin e Komisionit të ri për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) të Kuvendit të Kosovës dhe llogaridhënien të financave publike në Kosovë. Përgatitja e vizitës është menaxhuar nga KIPRED në Kosovë dhe do të dëshiroja të falënderoj në veçanti Artan Venharin dhe Albert Krasniqin për ndihmën e tyre në planifikimin e vizitës dhe aranzhimeve të bëra në Kosovë. Ky raport dhe rekomandimet e tija janë përgatitur për të ndihmuar efektshmërinë e KMFP-së, komisionit i cili është aktiv që nga nëntori i vitit 2009. Raporti nuk mund të jetë plotësisht gjithëpërfshirës për shkak të kohës së shkurtë të vizitës sime dhe mungesës së dialogut me kryesuesit e komisioneve dhe përfaqësuesit nga grupet partiake. Sidoqoftë, shpresoj se përmbajtja e raportit dhe rekomandimet do të merren në konsiderim si pjesë e tentimeve më të gjëra për të promovuar dhe forcuar demokracinë dhe qeverisjen e mirë në Kosovë.

II. LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE

AAK	ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS
AG	AUDITORI GJENERAL
AKR	ALEANCA KOSOVA E RE
KBF	KOMISIONI PËR BUXHET DHE FINANCA
KMFP	KOMISIONI PËR MBIKËQYRJEN E FINANCAVE PUBLIKE
DFP	DEPARTAMENTI PËR FINANCA DHE PERSONEL (JERSEY)
PVPE	PLANI VEPRUES PËR PARTNERITET EVROPIAN
BE	BASHKIMI EVROPIAN
PCN	PËRFAQËSUESI CIVIL NDËRKOMBËTAR
SNAISA	STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË AUDITIMIT PËR INSTITUCIONET SUPREME TË AUDITIMIT
KIPRED	INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE
LDD	LIDHJA DEMOKRATIKA E DARDANISË
LDK	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS
ZKA	ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT (MB)
ZAGJ	ZYRA E AUDITORIT GJENERAL
KLLP	KOMISIONI I LLOGARIVE PUBLIKE
PDK	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS
ISA	INSTITUCIONI SUPREM I AUDITIMIT
MB	MBRETËRIA E BASHKUAR
KB	KOMBET E BASHKUARA

III PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Me 2 nëntor 2009 Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP) është themeluar nga Kuvendi i Kosovës. Referimi i komisionit shkon në linjë me Komisionin e Llogarive Publike (KLLP), një komision që ekziston çdo herë e më shumë në legjislatura nëpër botë, por veçanërisht mbizotërues në sistemet Westminster. Komisionet e tilla janë përgjegjëse për ekzaminimin e llogarive publike, komentet mbi llogaritë publike dhe të gjitha raportet e hartuara nga Institucioni Suprem i Auditimit (ISA). Qëllimi i një KLLP-je është përmirësimi i ofrimit të politikës publike dhe sigurimi se qytetarët e marrin atë që e meritojnë: qeverisjen e mirë.

Ky raport është përgatitur si pjesë e iniciativës për të zgjeruar funksionimin e KMFP-së së re dhe llogaridhënien në financa publike në Kosovë. Për këtë e merr në konsiderim rolin dhe punën e Zyrës së Auditorit Gjeneral (ZAGJ), e udhëhequr momentalisht nga Lage Olofsson i cili është emëruar në këtë post në fillim të vitit 2009 nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN). Roli dhe mandati i tij është që të ndërtojë kapacitetin organizativ dhe të krijoj rrugën për një Institucion të qëndrueshëm Suprem të Auditimit (ISA) nën pronësinë kosovare.

Ka përkrahje të gjerë për punën e Auditorit Gjeneral (AGJ) aktual. Sidoqoftë, ka disa kritika për performancën dhe sjelljen e disa auditorëve brenda organizatës. Gjithashtu kemi çështjet që kanë të bëjnë me bazën ligjore të ZAGJ-it; mungesa e raporteve të performancës të pranuar nga KMFP-ja; dhe nëse zyreja është mjaftë e fuqishme që t'i bëjë ballë presioneve partiake kur AGJ aktual lëshon postin dhe pasardhësi i tij emërohet nga Kuvendi. Gjithashtu duhet konsideruar resurset për ZAGJ dhe KMFP.

Është krijuar marrëdhënia e punës në mes të ZAGJ dhe KMFP, por një marrëdhënie e vërtetë partneriteti duhet të themelohet. Kuvendi i Kosovës, përmes KMFP, është i varur nga raportimi me kualitet të lartë për auditimet për të ushtruar maturi efektive përderisa AGJ i nevojitet një Kuvend dhe KMFP efektiv për të siguruar se departamentet i marrin seriozisht rezultatet e auditimit. Ky është koncepti i "shtimit të vlerës" për raportet e AGJ.

Kërkesa themelore për qeverisje të mirë brenda Kosovës është duke zhvilluar një kulturë të llogaridhënies që do të kërkojë përfshirjen dhe përkrahjen e medie dhe shoqërisë civile në lidhje me çështjet e auditimit publik dhe punës së ZAGJ dhe KMFP. Në të njëjtën kohë, anëtarët e KMFP duhet të demonstrojnë njohuri më të mëdha për *raison d'être* të KMFP dhe ZAGJ që është për të inkurajuar, ndihmuar dhe siguruar përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të shfrytëzimit të parave publike. Fatkeqësisht, natyra e lartë partiake e politikës kosovare siç është e shprehur edhe në Kuvend ka depërtuar në punën e hershme të KMFP.

Gjithashtu është e nevojshme që Anëtarët tjerë, posaçërisht Kryesuesit e Komisioneve, të kuptojnë rolin dhe referimin e KMFP, në veçanti në lidhje me dallimet në mes të politikave dhe implementimit të politikave. Marrëdhënia në mes të KMFP dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa (KBF) në veçanti është vendimtar. KMFP ka marrë përsipër disa nga funksionet e KBF dhe këto dy komisione duhet të themelojnë një marrëdhënie konstruktive duke marrë parasysh rëndësinë e rolit të legjislaturës në *ex ante* dhe *ex post* të buxhetit. Fatkeqësisht ekzistojnë tensione në mes të dy komisioneve, të shkaktuara pjesërisht nga dy mandatet (të treguara në Shtojcën A) dhe pjesërisht nga çështjet që kanë të bëjnë me anëtarësinë dhe performancën. Vështirësitë tjera me të cilat ballafaqohet KMFP përfshijnë atë se si të sigurohet që rekomandimet e auditimit të konsiderohen dhe implementohen nga qeveria ose trupat relevant publik dhe për atë se si

komisioni duhet të masë performancën e vet duke tentuar që ta vendosë vetën brenda Kuvendit dhe jashtë tij.

Ky raport përmban rekomandime për të forcuar punën dhe performancën e KMFP, si dhe të ZAGJ. Sidoqoftë, raporti vjen në përfundim se tashmë më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet ambientit më të gjerë të llogaridhënies në të cilin edhe KMFP edhe ZAGJ veprojnë. Për momentin ambienti i jashtë nuk është i favorshëm për maturi të paanshme financiare. Kjo për shkak se pjesërisht strukturat e llogaridhënies shpesh i nënshtrohen nevojave të partive politike dhe pjesërisht për shkak se ekzekutivi dominon në Kuvend. Por nuk është e dukshme menjëherë se akterët brenda shoqërisë së Kosovës – nga qeveria, burokracia, Kuvendi, KMFP, ZAGJ, mediat dhe shoqëria civile – janë të vetëdijshëm për kërkesat dhe përgjegjësitë e llogaridhënies dhe të veprojnë në atë mënyrë për të përkrahur rezultatet korrekte, objektive dhe të parashikueshme. Një pyetje fundamentale duhet të bëhet në lidhje me atë se cila është mënyra më e mirë për të siguruar që principet dhe vlerat kryesore që nevojiten për të arritur deri tek një sistem i fortë i llogaridhënies horizontale ekziston brenda Kosovës.

IV. PËRMBLEDHJA E REKOMANDIMEVE

1. Është fat i keq që auditori i jashtëm për ZAGJ ende nuk është emëruar për vitin 2009 dhe KMFP duhet ta adresoj këtë si një çështje me prioritet.
2. Për të krijuar besim më të madh në ZAGJ dhe për të përkrahur tentimet aktuale të reformave nga AGJ, ose ZKA e MB ose Gjyqi i Auditimit të Sllovenisë duhet të ftohen për të kryer një vlerësim/auditim gjithëpërfshirës të ZAGJ në fund të Projektit të Binjakëzimit në 2011.
3. Ligji për ndërmarrjet publike duhet të shtrëngohet për të parandaluar organizatën, kompaninë ose ndërmarrjen që auditohet, që të emëroj auditorët e vet.
4. KMFP gjithashtu duhet të jetë më proaktive në sigurimin se ZAGJ ka ekspertizën dhe resurset që i mundësojnë për të matur dhe vlerësuar shpenzimet e qeverisë, duke pasur qasje në burimet zyrtare të informimit. Në anën tjetër, ISA duhet të thelloj bashkëpunimin dhe përkrahjen për KMFP përmes materialeve të rregullta informuese, gojore ose të shkruara, dhe caktimin e zyrtarit ndërlidhës parlamentar.
5. KMFP dhe ZAGJ mund të shohin të dobishme një protokoll me marrëveshje që do të qeveriste marrëdhëniet e caktuara në mes të AGJ, Kuvendit dhe qeverisë. Për këtë duhet të arrihet marrëveshja dhe të implementohet me ose pa bashkëpunimin e qeverisë. Protokoli mund të përfshijë një orar strategjik me marrëveshje për publikime, dëgjime, debate parlamentare dhe lajmërim; dhe caqet për arritjen e një bilanci më të mirë në mes të raporteve të rregullta dhe të performancës.
6. Përgjegjësia e KBF duhet të jetë e kufizuar për procesin e buxhetit *ex ante* – një fushë ku mbikëqyrja nga legjislatura është e një rëndësie vendimtare – dhe përgjegjësia e KMFP duhet të jetë në fazat *ex post* të ciklit buxhetor. Duhet të ketë një dallim të qartë dhe me marrëveshje në mes të maturës dhe autorizimit të shpenzimeve të propozuara qeveritare dhe tatimeve dhe mbikëqyrjen e shpenzimeve paraprake. Të dy pjesët e procesit buxhetor janë të rëndësishme së njëjtë.
7. KMFP duhet të bëhet komisioni i pestë kryesor ose i përhershëm i Kuvendit. Dy pjesët e ciklit buxhetor – autorizimi dhe implementimi i shpenzimeve – do të marrin të njëjtën rëndësi nga Kuvendi.
8. Kryesuesi i KBF nuk duhet të jetë anëtar i KMFP (dhe anasjelltas).
9. Marrëdhënia në mes të KBF dhe komisioneve tjera duhet të vlerësohet posaçërisht në fushën e shqyrtimit të buxhetit. Të gjitha komisionet duhet të japin rekomandime jo-obligative për KBF për shpenzimet brenda fushave të tyre. Një sistem i tillë do të siguronte përdorimin e ekspertizës sektoriale, si dhe zbatimin e kufizimeve buxhetore dhe përcaktimin e prioriteteve buxhetore përmes KBF. Kjo gjithashtu vlen për përgjegjësitë e shqyrtimit financiar *ex post* të KMFP. Përfundimet e KMFP duhet të kenë një ndikim të fuqishëm mbi punën dhe rekomandimet e KBF dhe vendimet e ardhshme të politikave buxhetore të qeverisë.

10. KMFP mund të konsideroj që të pyes Anëtarët që i bashkëngjiten KMFP të nënshkruajnë kodin e mirësjelljes (zyrtar ose jozyrtar) në të cilën ata do të zotoheshin për të respektuar natyrën jopartiake të Komisionit.
11. Asnjë anëtar i KMFP nuk duhet të marrë pjesë në konsiderimet e çfarëdo çështje nëse ai ose ajo kanë qenë anëtar të qeverisë për kohën relevante.
12. Kryesuesi i KMFP duhet të veproj në mënyrë më të pavarur nga presionet partiake se sa kryesuesit e komisioneve tjera, *edhe në komentimin e çështjeve jashtë komisionit*. Kjo do të ndihmojë veprimin efektiv të KMFP dhe do të gjeneroj më shumë besim dhe mbështetje për punën e tij.
13. KMFP duhet të krijoj një marrëdhënie të afërt me komisionet tjera funksionale dhe kryesore të cilat kanë përsipër mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e politikave specifike qeveritare në mënyrë që roli i tij unik të kuptohet dhe përkrahet. Nënshkrimi dhe respektimi i një memorandumi të mirëkuptimit është një opsion që duhet të merret në konsiderim.
14. KMFP mund të bëjë pyetjet vijuese para se të ndërmar një Kërkim (e marrë nga KLLP të Isle of Man).
 - Rëndësia ose rëndësia potenciale për çështjen për reputacionin e Kuvendit ose Kosovës më gjerë;
 - Besueshmëria e çfarëdo dyshimi për të cilin është kërkuar nga Komisioni që ta hetoj;
 - *Quantum*; shuma e parave të përfshira; dhe
 - Pyetja nëse çështja mund t'i referohet ndonjë komisioni tjetër ekzistues të Kosovës.
 - Këshilla nga AGJ
15. Kuvendi i Kosovës duhet të harmonizoj legjislaturën ose një kod të praktikës ku kërkohet nga qeveria që të reagoj ndaj raporteve dhe rekomandimeve të KMFP (dhe komisioneve tjera) për të siguruar se puna e tyre ka kuptim dhe prodhon rezultate.
16. Përveç kësaj raportet e KMFP të jenë të caktuara sipas orarit në Kuvend, duhet të ketë një debat vjetor mbi punën e komisionit, ndoshta të bazuar në Raportin Vjetor (ky rekomandim gjithashtu është i aplikueshëm për komisionet tjera të Kuvendit).
17. KMFP duhet të vlerësoj dhe raportoj masën deri në cilën KMFP mban azhurnimin me Raportet e AGJ si dhe koston e ofrimit të rezultatet (buxhetin e saj, kohën e shpenzuar nga personeli i parlamentit dhe Anëtarët).
18. KMFP duhet të vlerësoj dhe raportoj frekuencën e raporteve të saja si dhe rekomandimeve të pranuar, veprimet përcjellëse të ndërmarra, shtrirja e pranimi të implementimeve dhe nivelit të debatit të gjerë parlamentar dhe mbulimi nga mediat.
19. KMFP dhe ZAGJ duhet të provojnë që të masin përmirësimet e qëndrueshme në administrimin publik si rezultat i qëllimshëm i procesit të llogaridhënies nga KMFP dhe rezultatet e tija.

20. Ka përkrahje të mjaftueshme për KMFP në afatin e shkurtër përderisa KIPRED vazhdon udhëzimin dhe ndihmën e tyre për komisionin dhe ZAGJ të zhvilloj lidhjet e veta me komisionin përmes zyrtarit ndërlidhës parlamentar dhe informimeve të rregullta. Sidoqoftë, është nevoja që parlamenti të merr pronësinë e komisionit në afatin e shkurtër e të gjatë. Për këtë çelësi është te trajnimi – jo vetëm për Kryesuesin dhe Anëtarët por gjithashtu edhe për personelin e posaçërisht nëpunësit. Me rritjen e kapacitetit të personelit mbështetës të komisionit dhe KMFP pozicionohet më mirë brenda Kuvendit, Instituti KIPRED dhe akterët tjerë duhet të kalojnë më pak kohë çështjet e përditshme teknike të komisionit dhe të fokusohen në çështjet më të gjëra strategjike të llogaridhënies brenda Kosovës.
21. KMFP dhe KIPRED mund të hetojnë realizueshmërinë e dërgimit të një delegacioni të KMFP (përfshi nëpunësit) që të marr pjesë në shkollen vjetore verore për Komisionet parlamentare të llogarive publike në Universitetin La Trobe në Australi në shkurt 2011.
22. Nëpunësi mund të caktohet të merr pjesë në njërin prej KLLP në Uells, Skoci, ose Irlandë Veriore. Alternativë tjetër është se mund të kërkohet ndihmë nga ndonjë legjislaturë tjetër në formën e vizitës së nëpunësit në Kosovë i cili do të shërbente si këshilltar për Nëpunësin dhe Kryesuesin aktual, të mbikëqyr periudhën nga fillimi i Kërkimit, planifikimi i Dëgjimit, mbajtja e Dëgjimit, shkrimi i raportit etj.
23. Gjithashtu ekziston nevoja për të ndërtuar kapacitetet brenda Kuvendin për të rritur aftësinë e Deputetëve që të kuptojnë rolin e KMFP dhe çështjet më të gjëra të llogaridhënies. Ndërtimi i kapacitetit duhet të bëhet pas zgjedhjeve të ardhshme (në formë të seminarit pas-zgjedhor) dhe të sigurohet për të gjithë Deputetët. Fokusi i këtij seminari do të duhej të ishte përgjegjësitë e tyre si Deputet të Kuvendit e jo si përfaqësues të partive politike.
24. Roli, funksionet, raportet dhe financimi i të gjithë kujdestarëve (watchdogs) etik ose “institucionet e pavarura” brenda Kosovës duhet të rishikohen për të siguruar uniformitet në strukturë, praktika të mira dhe kornizë gjithëpërfshirëse është vendosur në mes të pavarësisë prej Ekzekutivit dhe llogaridhënies për Parlamentin. Një raport i tillë duhet të përfundohet para Zgjedhjeve të Përgjithshme të ardhshme.

V. PROGRAMI

22 qershor Takim me anëtarët e KMFP. Pesë prezantimet vijuese janë ofruar dhe diskutuar²:

- Komisioni i Llogarive Publike
- Marrëdhënia në mes të KLLP dhe Auditorit Gjeneral
- Përgatitja për një Dëgjim të KLLP
- Matja e performancës së KLLP
- Praktika dhe përvoja e mirë të KLLP tjera.

23 qershor Takimi me kryesuesit e komisioneve dhe përfaqësuesve nga grupet partiake në parlament dhe auditimi i llogarive publike³

24 qershor Takimi me përfaqësuesit e medieve dhe shoqërisë

Takimi me nëpunësen e KMFP, Fatime Qorri

Takimi me kryesuesin e KMFP, Haki Shatri

Takimi me Auditorin Gjeneral, Lage Olofsson

VI. HISTORIKU DHE KONTEKSTI

Kosova është e pavarur, e mbikëqyrur nga komuniteti ndërkombëtar pas përfundimit të procesit politik për të përcaktuar statusin final të Kosovës të paraparë në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB 1244. Zgjedhjet e fundit janë mbajtur në dhjetor 2007 që rezultojë me dy partitë më të mëdha në Kuvend (PDK dhe LDK) të cilat krijuan qeverinë e koalicionit. Opozita është e përbërë nga tri parti, AKR, LDD dhe AAK.

Kuvendi i Kosovës ka adoptuar deklaratën e pavarësisë me 17 shkurt 2008, duke deklaruar Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Deri më sot të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) e kanë njohur Kosovën (përveç Rumanisë, Spanjës, Qipros, Greqisë dhe Sllovakisë) si dhe një numër që është në rritje i vendeve tjera, përfshi Shtetet e Bashkuara të Amerikës..

Një prej pesë qëllimeve aktuale strategjike të Kuvendit të Kosovës është që të sigurojë mbikëqyrje efektive parlamentare të qeverisë. Kjo është pjesërisht reflektim i vëmendjes më të gjerë ndërkombëtare që është vendosur viteve të fundit mbi rolin e legjislaturës në mbikëqyrjen veprimet dhe aktivitetet e qeverisë. Tashmë ka pranim të gjerë se legjislativi efektiv dhe matura *financiare* ofrojnë një sigurim të integritetit të qeverisë dhe do të forcojë kapacitetin e parlamenteve që të mbikëqyrin ndarjen dhe shfrytëzimin e fondeve publike. Sidoqoftë, problemi që ekziston në shumë vende është se ambienti politik mund të mos jetë i përshtatshëm për mbikëqyrje efektive dhe në shumë demokraci të reja mund të mos ketë fare traditë të shqyrtimit

¹ Ka pasur takime të vazhdueshme dhe diskutime me përfaqësuesit e KIPRED gjatë vizitës sime.

² Kopje të secilit prezantim i janë dhënë KIPRED për t'i shpërndarë për anëtarët e KMFP.

³ Është fat i keq që ky takim është dashur të anulohet për shkak të mungesës së interesimit nga Deputetët.

të pavarur. Në të njëjtën kohë shumë legjislatura ballafaqohen me kufizime të kapacitetit kur kërkojnë llogari nga ekzekutivi. Këto janë disa prej çështjeve me të cilat Kosova ballafaqohet.

Njëri prej instrumenteve që parlamentet mund t'i shfrytëzojnë për të kontrolluar aktivitetet qeveritare është KLLP. KLLP është komisioni parlamentar përgjegjës për sigurimin e llogaridhënies financiare të qeverisë si dhe të ndihmoj llogaridhënien më të gjerë të ministrave dhe departamenteve të tyre ndaj parlamentit. KLLP është pjesë e infrastrukturës parlamentare që ndihmon në sigurimin e llogarisë së qeverisë për politikat vepruese dhe veprimet, dhe menaxhimin e shfrytëzimin e resurseve publike (McGee 2002).

Kosova iu është bashkangjitur një numri të vendeve⁴, përfshi vendet të cilat janë jashtë modelit tradicional "Westminster", në themelimin e KLLP (edhe pse është quajtur KMFP). Më herët mbikëqyrja e financave publike në Kuvendin e Kosovës është kryer përmes KBF, por "roli i tij si kujdestar i parave publike [ka qenë] vetëm simbolik dhe sipërfaqësor"⁵. Presioni ndërkombëtar ka shtyrë Kuvendin që me 24 korrik 2009 të merr vendimin për të themeluar KMFP. Komisioni është bërë operacional me 2 nëntor dhe që nga atëherë ka qenë përgjegjës për kontroll të buxhetit dhe kontroll të financave tjera publike.

VII. ZINXHIRI I LLOGARIDHËNIES BRENDA KOSOVËS⁶

A. Vizioni

1. Autorizimi i shpenzimeve qeveritare nga Kuvendi;
2. Prodhimi i llogarive vjetore nga departamentet e qeverisë dhe organet tjera publike;
3. Auditimi i këtyre llogarive nga AGJ;
4. Dorëzimi i raportet të auditimit tek Kuvendi për t'u rishikuar nga KMFP;
5. Nxjerrja e raporteve dhe rekomandimeve nga KMFP; dhe
6. Reagimi i qeverisë ndaj raporteve të KMFP (brenda një periudhe me marrëveshje).

B. Disa probleme

- i. Primati i marrëdhënieve joformale të llogaridhënies (lidhjet me partitë politike);
- ii. Mungesa e zgjedhëse politik të informuar dhe të mobilizuar vendor për të përkrahur kulturën e llogaridhënies;
- iii. Mungesa e personelit, hapësirave dhe resurseve financiare (edhe në Zyrën e Auditorit Gjeneral (ZAGJ) edhe në KMFP);
- iv. Marrëdhënia në mes të KMFP dhe KBF
- v. Aftësia dhe qasja e KMFP, dhe
- vi. Marrëdhënia në mes të KMFP the ISA (posaçërisht Auditori Gjeneral).

⁴ Shembujt përfshijnë Republikën Çeke, Butanin, Guernsey, Uellsin, Skocinë, Jersey, Etiopia, Finlandën, Liberia, Nepal, Ruanda, dhe Tailanda.

⁵ Venhari, A & Marmullakaj, Q (2009) Mbikëqyrja e financave publike në Kosovë, KIPRED, Prishtinë, Kosovë.

⁶ Zinxhiri i llogaridhënies është adoptuar nga një kornizë e përgatitur nga Instituti i Zhvillimit të Jashtëm (2008).

VIII. INSTITUCIONI SUPREM I AUDITIMIT – ZYRA E AUDITORIT GJENERAL DHE ZYRA E AUDITIMIT TË KOSOVËS

AGJ aktual, Lage Olofsson, është emëruar në postin e tij në fillim të vitit 2009 nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil (PNC). Kushtetuta dhe Ligji mbi Themelimin e Zyrës së Auditorit Gjeneral të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës cakton mandatin dhe detyrat e tij. Ai kërkohet që të jetë i pavarur nga qeveria dhe të raportoj direkt tek Kuvendi. Roli i tij është që të ndërtojë kapacitetin organizativ dhe të përgatitë rrugën për një ISA të qëndrueshme nën pronësi të Kosovës⁷.

Zyra kryen dy lloje të auditimit – Auditimi vjetor i Rregullsisë së Buxhetit të Konsoliduar dhe organizatat buxhetore dhe Auditimi i Performancës ku ekzaminohet nëse programet e qeverisë janë duke u menaxhuar duke pasur parasysh ekonominë dhe efektshmërinë. Auditimi i performancës nuk është i obligueshëm dhe varet nga vet AGJ. Në sezonin e auditimit 2008/09 (e cila ka përfunduar në shtator 2009) zyra ka kryer 53 auditime të obligueshme të rregullsisë, duke mbuluar 80% të shpenzimeve të përgjithshme dhe 95% të të hyrave të përgjithshme. Përveç kësaj, janë kryer dy raportet e para të performancës. Katër opinione ishin të pakualifikuara, shtatëmbëdhjetë opinione ishin të pakualifikuara me theks në çështje, dhe katër opinione ishin të kualifikuara. Auditimi bazohet në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit për Institucionet Supreme të Auditimit (SNAISA)⁸.

Në diskutimet e mia me anëtarët e KMFP dhe akterët tjerë, kam hasur në shumë pak kritika ndaj AGJ aktual, i cili është pa si i pavarur dhe mbështetës për punën e KMFP. Kryesuesi i KMFP, z. Hakri Shatri, më ka konfirmuar se komisioni nuk ka pasur asnjë problem me AGJ i cili komunikon normalisht dhe respekton kërkesat e komisionit⁹.

Sidoqoftë, ka mungesë të besimit në mes të disa partive për nivelin e pavarësisë dhe performancës të disa auditorëve që punojnë brenda ZAGJ. Kryesuesi i KMFP ka ngritur brengën tek AGJ se brenda ZAGJ ka disa auditor individual të cilët janë politikisht të ndikuar edhe pse i gjithë personeli që punon në ZAGJ duhet të nënshkruar deklaratat vjetore të kodit të mirësjelljes, ku ceket respektimi i kërkesave etike profesionale, dhe vërtetimi për sjelljen e duhur personale dhe profesionale. Prapëseprapë dyshimet për ndikim partiak dhe konflikt të interesave mbesin. Gjithashtu ka çështje që kanë të bëjnë me bazën ligjore të ZAGJ; kualitetin e raporteve të auditimit të pranuar nga KMFP; dhe nëse zyra është mjaftë e fuqishme që të përballoj presionet partiake kur AGJ aktual të lëshoj postin dhe pasardhësi i tij të emërohet nga Kuvendi prej brenda Kosovës. Pavarësia dhe objektiviteti janë esenciale.

AGJ momentalisht është duke zhvilluar makinerinë e brendshme të zyrës si dhe është duke kryer një reformë organizative dhe funksionale të ZAGJ. Ai është duke kërkuar që të ristrukturoj zyrën nga një organizatë e cila duke e ngjashme me një gjyq që shikon saktësinë e deklaratave financiare (shpesh pas shumë kohe) drejt një modeli të agjent-ndryshimit të punës. Për shembull raportet e përkohshme janë futur gjatë vitit financiar.¹⁰ Kjo duhet të inkurajohet dhe AGJ citon rezultatet siç janë përmirësimet në profesionalizëm të personelit që punon në ZAGJ, mbulesë më të mirë të auditimit dhe kualitet më i lartë në operacionet e auditimit.¹¹

⁷ Raporti vjetor i performancës ZAGJ 2009, f.4.

⁸ Raporti vjetor i performancës ZAGJ 2009.

⁹ Intervistë me Haki Shatrin, Kryesues i KMFP, 24 qershor 2010.

¹⁰ Intervistë me Lage Olofsson, Auditor Gjeneral i Kosovës, 24 qershor 2010.

¹¹ Raporti Vjetor i Performancës 2009, f.17

Brengat mbesin në mes të akterëve brenda Kuvendit. Në vitin 2009 auditorët e dërguar në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit janë përjashtuar nga institucioni dhe AGJ ka qenë i obliguar që të dërgoj dy auditor tjerë (kjo nuk përmendet në Raportin Vjetor të Performancës). Në takimin e KMFP të datës 30 qershor 2010, njëri prej anëtarëve ka sfiduar një raport nga ZAGJ duke thënë se udhëheqësi i ekipit që ka kryer auditimin ka pasur konflikt interesi. Kjo shpesh del si problem – i vërtetë ose i perceptuar – në vendet në tranzicion ku shumë njerëz njohin njëri tjetrin dhe kanë lidhje dhe miqësi me të tjerët. Ka disa dyshime brenda KMFP se raportet e auditimit nga ZAGJ deri në një shkallë janë të ndikuar nga ndikimet dhe presionet e jashtme.

Secilin vit, kërkohet nga Kuvendi që të përzgjedh një auditor të jashtëm për të audituar Deklaratat Vjetore Financiare (DVF) të ZAGJ. **Është fat i keq që auditori i jashtëm ende nuk është përzgjedhur dhe KMFP duhet ta adresoj këtë si prioritet.** Në afat të gjatë, AGJ ka thënë se ai do të caktoj rishikime periodike të jashtme nga të tjerët, siç janë ISA tjera. ZAGJ ka nënshkruar së voni një Projekt Binjakëzimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) të Mbretërisë së Bashkuar, si Partner Kryesor, dhe Gjyqit Slloven të Auditimit (si Partner Junior). Ekspertët nga MB dhe Sllovenia janë duke punuar për së afërmi me partnerët e tyre nga Kosova për t'i ndihmuar atyre në aplikimin e praktikave më të mira të BE për auditimin e fondeve publike. Projekti është koncentruar në udhëzimin e ekipeve të auditimit të ZAGJ në auditimet e tyre të rregullsisë dhe performancës. Gjithashtu do të ketë ndihmë për të krijuar rregulloret e reja të brendshme për ZAGJ si dhe ndihmë për zhvillimin e burimeve njerëzore. Ky projekt zgjatë 2 vite dhe do të përfundoj në korrik të vitit 2011¹². **Unë besoj në gjenerimin e besimit më të madh në ZAGJ dhe në përkrahjen e tentimeve aktuale për reforma të AGJ, qoftë ZKA e MB ose Gjyqi Slloven i Auditimit do duhej të ftohet për të kryer një vlerësim/auditim gjithëpërfshirës të performancës së ZAGJ në fund të Projektit të Binjakëzimit në korrik të vitit 2011.**

Baza ligjore gjithashtu duhet shtrënguar. Një shembull që më është dhënë nga një numër i njerëzve në Kosovë është ligji aktual mbi ndërmarrjet publike i cili thotë se organizata, kompania, ose ndërmarrja që auditohet do të emëroj auditorët e vet. Rezultati i kësaj është se auditimet e tilla janë shumë sipërfaqësore. Përveç këtij auditivi ZAGJ ka filluar të kryej auditime të menaxhmentit të cilat futen me thellë në atë se si menaxhohet ndërmarrja publike dhe si kryhen operacionet. Ky auditim është më relevant dhe objektiv për akterët brenda Kosovës¹³. **Kjo mospërputhje ligjore duhet të largohet në rastin e parë.**

A. Resurset

Kryesuesi i KMFP është shumë përkrahës për atë që fusha e auditimit të zgjerohet që të përfshijë më shumë vlerësime të performancës përveç auditiveve të rregullsisë. Sidoqoftë, ai është i brengosur që ZAGJ nuk ka kapacitet për të kryer vlerësime të tilla¹⁴.

Buxheti fillestar për vitin 2009 për ZAGJ ka qenë 1,106,963 EUR, një zbritje nga vitit i kaluar. Ishin 64 personel të auditimit në vitin 2009 dhe 21 personel mbështetës. Kjo krahasohet me 280

¹² Informata nga Raporti Vjetor i Performancës dhe faqja e internetit të ZAGJ, <http://www.ks-gov.net/oag/english/home.htm>.

¹³ Një shembull i fundit është Raporti i Auditimit mbi Menaxhimin Financiare të N.Q. "Termokos" Prishtinë për fundin e vitit me 31 dhjetor 2009 që është në dispozicion në faqen e internetit të ZAGJ: (<http://www.ksgov.net/oag/Raportet%20Anglisht/2009/TERMOKOS%202009%20Final%20150610%20Eng%20QM.pdf>) [e qasur me 30 qershor 2010].

¹⁴ Intervistë me Haki Shatrin, Kryesuesi i KMFP, 24 qershor 2010.

personel të auditimit të cilët mbështesin Auditorin Gjeneral të Uellsit¹⁵. Janë 293 personel me orar të plotë në Audit të Skocisë me 31 mars 2010. Në vitet 2009/10, Audit i Skocisë ka shpenzuar £27.7 milion në shërbimet për Auditorin Gjeneral dhe Komisionin e Llogarive; kjo është më pak se 0.1 përqind të £36 miliardë që shpenzohen nga organet që auditohen. Shumica e këtyre shpenzimeve rikthehen si ngarkesa për këto organizata, me bilancin e pranuar si financim i drejtpërdrejt nga Parlamenti i Skocisë¹⁶.

Plani Veprues për Partneritet Evropian (PVPE) me marrëveshje në mes të Kosovës dhe BE ka paraparë një rritje prej 20% të numrit të personelit vendor për të kompensuar zvogëlimin e personelit ndërkombëtar. Kjo nuk ka ndodhur dhe AGJ ka raportuar se është duke u ballafaquar me sfida në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e personelit që ka përvojë dhe aftësi për të absorbuar dhe përballur me procesin e reformave. **Është esenciale që KMFP dhe Kuvendi i Kosovës të bëjnë presion te qeveria që të respektoj marrëveshjen PVPE dhe të filloj të ndajë resurse të mjaftueshme për të lejuar ZAGJ që ta përmbush mandatin e vet.**

Bashkëpunimi në mes të ZAGJ dhe KMFP duhet të intensifikohet për të krijuar një marrëdhënie të vërtetë partneriteti. Duhet të kuptohet dhe të pranohet se Kuvendi i Kosovës, përmes KMFP, varet nga raportimi për auditime me kualitet të lartë për të ushtruar shqyrtimet efektive përderisa AGJ kërkon një Kuvend dhe KMFP efektiv për të siguruar se departamentet i marrin rezultatet e auditimit seriozisht. Ky është koncepti i “shtimit të vlerës” për raportet e AGJ. AGJ ka shprehur brengë, për shembull, për interesimin e kufizuar nga Kuvendi për të ndërmarrë veprime mbi cilindo raport i cili nuk është i përshatur për kornizën kohore të procesit buxhetor.¹⁷

Në të njëjtën kohë, KMFP nuk duhet të devijoj ose manipuloj me AGJ; AGJ duhet të lejohet që të përcaktoj fokusin e punës së tij në pajtim me çfarëdo kërkesë relevante legjislative. Gjithashtu duhet kuptuar se raportet e ZAGJ nuk duhet të influencohen ose aprovohen nga cilado parti qoftë nga ekzekutivi, legjislatura ose KMFP. Një raport i auditimit nga ISA është pikërisht kjo; nuk mund të ndryshohet, por natyrisht KMFP ka të drejtë të nxjerr raportet e veta bazuar në gjetjet e specializuara të auditimit.

Në fund, KMFP gjithashtu duhet të jetë proaktiv për të siguruar se ZAGJ ka ekspertizën dhe resurset që i mundësojnë shqyrtimin dhe vlerësimin e shpenzimeve qeveritare, me qasje në burime zyrtare të informimit. Për këtë, ISA duhet të thellojë bashkëpunimin dhe mbështetjen për KMFP përmes materialeve të rregullta informuese, gojore ose me shkrim, dhe caktimin e zyrtarit ndërlidhës parlamentar. KMFP dhe ZAGJ mund ta shohin si të dobishme krijimin me marrëveshje të një protokollit që do të qeveriste marrëdhëniet e duhura në mes të Auditorit Gjeneral, Parlamentit dhe qeverisë, me ose pa bashkëpunimin e ekzekutivit. Protokollin mund të përfshijë afatet strategjike kohore me marrëveshje për publikimet, dëgjimet, debatet parlamentare dhe njoftimet; dhe caqet për arritjen e një bilanci më të mirë në mes të raporteve të rregullsisë dhe performancës.

¹⁵ <http://www.wao.gov.uk/howeare/howeare.asp>. ZKA e MB punëson rreth 900 punëtor, por nuk është një krahasim i dobishëm.

¹⁶ Raporti Vjetor i Auditit të Skocisë 2009/10.

¹⁷ Raporti Vjetor i Performancës 2009, f.9.

IX. KOMISIONI PËR MBIKËQYRJEN E FINANCAVE PUBLIKE

Bazuar në hulumtimin e përgatitur nga Instituti i Bankës Botërore (IBB)¹⁸ një KLLP ideal do të kishte karakteristikat vijuese:

1. Do të ishte i vogël (5-11 anëtar);
2. Figura të larta nga opozita do të ishin të përfshira në të, mundësisht edhe ta kryesojnë;
3. Kryesuesi do të ishte një parlamentar i lartë, me mendim korrekt dhe i respektuar;
4. Do të kishte personelin adekuat;
5. Rolet e tija do të kuptoheshin qartë;
6. Do të mbante takime të rregullta dhe të shpeshta;
7. Dëgjimet do të ishin të hapura me transkriptime që do të ofroheshin publikisht;
8. Një komision drejtues do të planifikonte punën; në mënyrë tipike duke marrë dëshmi nga një zyrtar;
9. Raportet e auditorëve do t'i referoheshin automatikisht KLLP me Auditorin që takohet me ta për t'i diskutuar ato;
10. KLLP ndonjëherë do të hetonte çështje tjera prej atyre që janë ngritur nga Auditori;
11. Do të kërkonte koncenzus;
12. Raportet do të nxirreshin për Parlamentin së paku një herë në vit;
13. Do të kishte masa për të monitoruar implementimin e rekomandimeve;
14. Auditori do të përdorej si këshilltar; dhe
15. Do të kishte debat vjetor parlamentar për punën e tij.

Nga diskutimet dhe vështrimet e mia gjatë vizitës sime, karakteristikat që kanë nevojë të zhvillohen brenda KMFP në Kosovës janë 5, 11 dhe 13. Për këtë vëmendje e veçantë i është kushtuar këtyre tri karakteristikave në këtë raport.

A. Marrëdhënia në mes të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa

Komisioni për Buxhet dhe Financa me herët ishte përgjegjës për kontrollin buxhetor dhe kontrollin e financave publike, por një vlerësim i vitit 2008 për Kuvendin e Kosovës kishte nxjerrë si përfundim se ka qenë “i ngarkuar me numër të madh të projekt ligjeve në procedurë, nga analizat e implikimeve buxhetore të secilit projekt ligj të dorëzuar në Kuvend dhe me përgatitjen e buxhetit të Kuvendit”.¹⁹

Vendimi për të larguar auditimin financiar nga mandati i këtij komisioni të KMFP e re do duhej përshëndetur. Sidoqoftë, ka tensione të qarta në mes të dy komisioneve, e shkaktuar pjesërisht nga dy mandatet (të treguar si Shtojca C) dhe pjesërisht nga anëtarësia. Përkundër arritjes së marrëveshjes për mandatet e reja për dy komisionet, ende ekzistojnë fusha të duplikimit. Për shembull KBF ka mandatin që të mbikëqyr *implementimin* e ligjit për Menaxhimin dhe Përgjegjësitë e Financave Publike, si dhe ligjet tjera që kanë të bëjnë me financat publike;

¹⁸ Staphenurst, F., *et.al.* (2007) Shqyrtimi i shpenzimeve publike: vlerësimi i performancës së Komisioneve të Llogarive Publike. Në: McGee, D., *Procesi Buxhetor, Domosdoshmëri Parlamentare*. Londër: Pluto Press, f. 162.

¹⁹ Milan Martin Cvikl (2008). *Mandati i Ri, Mundësitë e Reja*, OSBE, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Assessment_Report_English.pdf [qasur me 30 qershor 2010]

gjithashtu është i angazhuar në rishikimin e programit të Qeverisë, mënyrën dhe nivelin e implementimit të tij në fushën e financave dhe jep rekomandime për Kuvendin,; dhe në fund rishikon raportet periodike të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, për shpenzimet e institucioneve të Kosovës dhe organizatave buxhetore të cilat i raportojnë Kuvendit.

Në vështrimin tim mandati i KBF duhet të fokusohet edhe më shumë në buxhet dhe implikimet financiare të legjislacionit të ri duke i lënë KMFP hapësirë dhe autoritet që të merret me çështjen se si janë shpenzuar paratë. Me fjalë tjera, përgjegjësia e KBF duhet të kufizohet në procesin buxhetor *ex ante* – një fushë ku mbikëqyrja e legjislaturës është e një rëndësie vendimtare – dhe përgjegjësia e KMFP duhet të jetë në fazën *ex post* të ciklit buxhetor. Duhet të ketë një dallim të qartë dhe me marrëveshje në mes të shqyrtimit dhe autorizimit të shpenzimeve dhe tatimeve të propozuara qeveritare (*ex-ante*) dhe mbikëqyrjen e shpenzimeve të kaluara (*ex-post*).

Përvoja e Parlamentit të Skocisë mund të jetë e dobishme. Parlamenti është themeluar në vitin 1999 pas kalimit të kompetencave në Mbretëri të Bashkuar dhe ka 129 deputet – madhësi e ngjashme me Kosovën. Kutia më poshtë tregon se si Parlamenti ka ndarë qartazi kompetencat e Komisionit të Financave dhe Llogarive Publike.

Kutia 1: Referimi i Komisionit të Llogarive Publike dhe Komisionit të Financave të Parlamentit Skocez²⁰

Komisioni i Llogarive Publike

Referimi i Komisionit të Llogarive Publike është që të konsideroj dhe raportoj mbi—

- (a) çfarëdo llogarie të sjellë para Parlamentit;
- (b) çfarëdo raporti të sjellë para ose të bërë për Parlamentin nga Auditorit Gjeneral i Skocisë; dhe
- (c) çfarëdo dokumenti tjetër të sjellë para Parlamentit, ose që i referohet atij nga Byroja Parlamentare apo nga Auditori Gjeneral i Skocisë, në lidhje me kontrollin financiar, llogaritë dhe auditimin në lidhje me shpenzimet publike.

Komisioni i Financave

Referimi i Komisionit të Financave është që të konsideroj dhe raportoj mbi -

- (a) çfarëdo raporti ose dokumenti tjetër të sjellë para Parlamentit nga anëtarët e Ekzekutivit Skocez ku përmbahen propozimet për, ose buxhetet e, shpenzimeve publike ose propozimet për sjelljen e rezolutave të ndryshimit të tatimeve, duke marrë parasysh çfarëdo raporti ose rekomandimi që ka të bëjë me dokumente të tilla që i janë dhënë atyre nga çfarëdo komisione tjetër që kanë fuqi që të konsiderojnë dokumente të tilla ose ndonjë pjesë të tyre;

²⁰ Për informata për komisionet dhe si veprojnë ato në Parlamentin e Skocisë shikoni <http://www.scottish.parliament.uk/business/committees/index.htm>.

(b) çfarëdo raporti të bërë nga ndonjë komision ku caktohen propozimet në lidhje me shpenzimet publike;

(c) ligjet buxhetore; dhe

(d) çfarëdo çështje tjetër që ka të bëjë ose që ndikon në shpenzimet e Administratës Skoceze ose shpenzimet tjera që paguhen nga Fondi i Konsoliduar Skocez.

2. Komisioni gjithashtu mund të konsideroj dhe, aty ku mendon se është e duhur, të raportoj te Parlamenti për kohën e Fazave të Ligjeve Buxhetore dhe për trajtimin e punëve financiare.

3. Në këto Rregulla, “shpenzim publik” nënkupton shpenzimet e Administratës Skoceze, shpenzimet tjera që paguhen nga Fondi i Konsoliduar Skocez dhe çfarëdo shpenzimi tjetër që paguhet nga tatimet, ngarkesat dhe të hyrat tjera publike.

Duplifikimi dhe ndërlihdja në mes të KMFP dhe KBF përkeqësohet nga dy probleme ose tensione tjera. E para KBF është komisioni i përhershëm i Kuvendit përderisa KMFP është komision funksional. E dyta është prezenca e Kryesuesit të KBF në anëtarësinë e KMFP.

Sipas Nenit 70 të Rregullave të Procedurave, Kuvendi emëron komisionet kryesore, funksionale dhe *ad-hoc*. KBF është një prej katër komisioneve kryesore ose të përhershme²¹ përderisa KMFP është një prej 12 komisioneve funksionale²². Sipas traditës KLLP në vende tjera shpesh konsiderohet si komisioni i lartë parlamentar, por kjo nuk është e aplikueshme në kontekst të Kosovës. **Sidoqoftë, KMFP duhet të bëhet komisioni i pestë kryesor duke marrë parasysh rëndësinë qendrore të llogaridhënies publike financiare.** Për shembull në Parlamentin Skocez Komisioni i Financave dhe Komisioni i Llogarive Publike – ekuivalent me KBF dhe KMFP – janë komisione të detyrueshme. Në Irlandën Veriore KLLP është komisioni i përhershëm dhe në Kuvendin e Uellsit i jepet klasifikim i njëjtë edhe Komisionit Financiar edhe KLLP. Në këtë mënyrë dy pjesët e ciklit buxhetor – autorizimi dhe implementimi i shpenzimeve – marrin të njëjtën rëndësi nga Kuvendi.

Çështja e dytë është prezenca e kryesuesit të KBF si anëtar i KMFP. Kjo ka shkaktuar disa shqetësime dhe tensione të padëshirueshme të cilat vetëm rriten nga dallimi në mes të dy komisioneve (shikoni më lartë) dhe fakti se njëri kryesues (KBF) është nga koalicioni qeverisës dhe tjetri kryesues (KMFP) është nga Opozita²³. **Anëtarësia e dyfishtë në komisione në një Kuvend me madhësi të Kosovës (120) është e pashmangshme, por mendoj se ka konflikt të interesit, të perceptuar ose të vërtetë, nëse kryesuesi i njërit prej dy komisioneve është edhe anëtar i komisionit tjetër. Kemi gjithashtu konsiderimet praktike: kryesia e cilitdo komision është një detyrë e rëndësishme dhe e lodhshme dhe është e sigurt se do të merr shumicën e kohës së kryesuesit. Është e pashmangshme se ata do të kenë më pak kohë**

²¹ Të tjerat janë Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimit; Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësor; dhe Komisioni për Integritet Evropian.

²² Komisionet tjera funksionale janë Komisioni mbi Çështjet e Jashtme; Komisioni mbi Arsimin, Shkencën, Teknologjinë, Kulturën, Rininë dhe Sportet; Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Telekomunikacion; Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale; Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media; Komisioni për Çështje të Brendshme dhe Siguri; Komisioni për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione; Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës; Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës; dhe Komisioni mbi Mandatet, Imunitetet dhe Rregullat e Procedurës së Kuvendit.

²³ Kryesuesi aktual i KMFP ka qenë anëtar i KBF, por ka dhënë dorëheqje pas përzgjedhjes si kryesues i KMFP.

për detyra tjera. Rekomandimi im është që kjo të parandalohet qoftë në rregullat e procedurës ose në një memorandum mirëkuptimi në mes të dy komisioneve.

Edhe pse kjo mund të jetë jashtë termave të referencës së këtij raporti, mendoj se **marrëdhënie në mes të KBF dhe komisioneve tjera duhet të ekzaminohet sa i përket shqyrtimit të buxhetit**. Avantazhi kryesor i KBF në shqyrtimin e propozimeve buxhetore dhe propozimeve të shpenzimeve nga ekzekutivi është se mund të fokusohet në kornizën e përgjithshme fiskale. Gjithashtu është dukshëm më lehtë që qeveria të mbahet përgjegjëse për projekt buxhetin e tyre përmes shfrytëzimit të një komisioni të vetëm të fuqishëm. Sidoqoftë, komisionet funksionale të Kuvendit kanë ekspertizë në fusha të caktuara që shqyrtohen dhe për këtë janë më mirë të përgatitura që të merren me çështjet buxhetore në sektorët e tyre. **Komisionet do duhej të jepnin rekomandime jo-obliguese për KBF për shpenzimet në fushat e tyre²⁴**. Një sistem i tillë do të siguronte shfrytëzimin e ekspertizës sektoriale, si dhe zbatimin e kufizimeve buxhetore dhe përcaktimin e prioriteteve buxhetore përmes KBF. Kjo është gjithashtu e vërtetë për përgjegjësit *ex post* të shqyrtimit financiar të KMFP. Përfundimet e KMFP duhet të kenë një ndikim të fuqishëm mbi punën dhe rekomandimet e KBF dhe vendimet e ardhshme për politikat buxhetore nga qeveria.

B. Një komision partiak

Qëllimi i KLLP është përmirësimi i dhënies së politikave publike dhe për të siguruar që qytetarët të marrin atë që e meritojnë, të themi, qeverisje të mirë. Vëzhgimi parlamentar (financiar) duhet të veprojë si përmbajtës i praktikave të këqija. Kërkesa themelore për qeverisje të mirë brenda Kosovës po zhvillon një kulturë të llogaridhënies e cila do të kërkojë përfshirjen dhe mbështetjen e medieeve dhe të shoqërisë civile në lidhje me çështjet e auditimit publik si dhe për punën e ZAGJ dhe KMFP. Në të njëjtën kohë, anëtarët e KMFP duhet të kuptojnë se qëllimi i tyre përfundimtar është inkurajimi, asistimi dhe sigurimi i përmirësimeve në efektshmërinë dhe efikasitetin e shfrytëzimit të parasë publike.

Fatkeqësisht, natyra e tepruar partiake e politikës kosovare siç shprehet në Kuvend është përhapur në punën fillestare të KMFP. Përkatesia partiake do të shkaktojë probleme në shumicën e komisioneve, por është shumë i rrezikshëm për një komision auditimi – KMFP nuk do të jetë asnjëherë vërtet i efektshëm nëse anëtarët e tij u japin prioritet interesit partiak. Ky është një problem i sjelljes e jo i faktorit institucional. Me pak fjalë, Anëtarët duhet të ndahen në mes të rolit të tyre si anëtarë të Partisë dhe rolit të tyre si anëtarë të KMFP me qëllim të prodhimit të raporteve unanime. Anëtarët e KMFP nuk duhet të paragjykojnë në meritën e një politike të caktuar. **Një qasje të cilën KMFP dëshiron ta merr parasysh është tu kërkojë Anëtarëve që anëtarësohen në KMFP të nënshkruajnë një kod të sjelljes (formal apo joformal) në të cilin ata zotohen se do të respektojnë natyrën jo-partiake të Komisionit. Një parim tjetër i rëndësishëm është se asnjë anëtar i KMFP nuk duhet të merr pjesë në gjykimin e tij për çfarëdo çështjeje nëse ai apo ajo ka qenë anëtar i qeverisë në kohën për të cilën bëhet fjalë.**

Përfundimisht, praktika punuese që i përshtatet Kosovës duhet të krijohet për tu kujdesur dhe për të mbajtur bashkëpunim të efektshëm ndër-partiak. Përgjegjësia bie në Kryesuesin e KMFP për të ofruar lidhshmëri të nevojshme për vlera efektive dhe praktika punuese në komision.

²⁴ Në disa vende, komisionet financiare aprovojnë kufijtë agregat për fusha të ndryshme të shpenzimit, përderisa komisionet sektoriale ose të departamenteve kanë fuqinë që të formojnë buxhetin e departamenteve nën juridiksionin e tyre. Një strukturë e tillë me dy shtylla për propozime të shpenzimeve përdoret në Suedi.

Kryesuesit e komisioneve bëhen figura publike më të profilizuara dhe nga ta pritet të komentojnë mbi çështjet që kanë të bëjnë me komisionin e tyre. Kjo gjë bëhet veçanërisht e rëndësishme për KMFP pasi që nga kryesuesi, që vjen nga Opozita, pritet t'i avancojë interesat e KMFP në Kuvend dhe më tutje dhe të kërkojë bashkëpunim të plotë nga ministrat dhe nga burokracia në zbatimin e rekomandimeve të komisionit. **Për ta bërë këtë, Kryesuesi i KMFP duhet të veprojë në mënyrë më të pavarur nga presioni partiak sesa kryesuesit e komisioneve tjera, edhe kur komentojnë mbi çështjet jashtë komitetit. Kjo do të ndihmojë në operimet efektive të KMFP dhe të gjenerojë besim më të gjerë dhe mbështetje për punën e tyre.**

C. Respektimi i dallimeve në mes të politikës dhe zbatimit të politikës

Përkatësia partiake jo vetëm se është anti-produktive dhe e padobishme, por është edhe e panevojshme. Përqendrimi i KMFP duhet të jetë mënyra në të cilën burimet janë sistemuar në zbatim të një politike. Kjo nuk është ideologjike e as çështje partiake. Përvoja e krijimit të KLLP-ve të fundit sugjeron se teksta komisioni fiton përvojë, ai do t'i kuptojë më mirë kufijtë në mes të politikës dhe zbatimit të politikës. Në Britani, për shembull, zbatimi i politikës përfshin ato raste ku Ministrat janë të përfshirë në bërjen e vendimeve të detajuara se si do të duhej të zbatohet politika. Është gjithashtu e nevojshme që Anëtarët tjerë, në veçanti Kryesuesit e Komisioneve, të kuptojnë këtë pikë kritike si dhe parimet në vazhdim, të adaptuara nga KLLP sapo-krijuar në Guernsey, mund të ndihmojnë në punën e KMFP.

1. KMFP do t'i duhet ta dijë se çka është një politikë para se të përcaktojë se a është duke u zbatuar me kujdes të duhur ndaj vlerës për parane.
2. KMFP tutje duhet të kërkojë t'i shohë planet dhe objektivat, si dokumentacion për ekzaminimin temave specifike, e jo me qëllim të ekzaminimit të vetë politikës por si pikënisje për ekzaminimin e tij të vlerës së parasë.
3. KMFP mund të dëshirojë të ekzaminojë analizën financiare prapa politikave. Kjo është për të siguruar se vlerësimet dhe projektimet financiare mbi të cilat janë promovuar politikat, janë të bazuara fortë dhe janë përcjellë procedurat e duhura.

Shembujt e mëposhtëm, sërish të adaptuar nga, janë me vend.

Politika	Komisionet funksionale/kryesore	KMFP
Të riorganizohet edukimi sekondar, pas-16 dhe edukimi me nevoja të veçanta.	A janë të përshtatshme politikat e Departamentit të Edukimit për nevojat edukative të Kosovës?	A po fuqizohen në mënyrë efektive dhe të efektshme programet individuale të Departamentit për zbatimin e politikave?
Të sigurohet shëndeti më i mirë i arritshëm për pjesën më të madhe të banorëve përbrenda burimeve në dispozicion	A po kanë sukses politikat? A ka boshllëqe në politika? A janë të arsyeshme prioritetet?	A po i përmbush Departamenti objektivat politike dhe a po i shfrytëzon më së miri burimet?

Të sigurohet se Kosova rritë taksat e të ardhurave vjetore për t'i mbuluar shpenzimet	Cilat janë politikat/prioritetet e qeverisë për taksat dhe shpenzime?	A janë duke i mbledhur autoritetet të gjitha të ardhurat vjetore nga taksat që i ka miratuar legjislatura? A i përcjellin të gjitha borxhet e taksave me përpikmëri dhe me efikasitet?

Është gjithashtu me rëndësi të njihet potenciali për mbulim (shih tabelën nga Guernsey). Kur merret parasysh raporti në mes të KMFP dhe komisioneve tjera të Kuvendit, ia vlen të theksohet se në shumicën e vendeve me KLLP, asnjë komision tjetër nuk është i përfshirë në vëzhgimin e raporteve të auditimit. Mirëpo, në disa vende është e lejueshme që komisionet tjera të marrin dëshmi nga një raport i ZKA nëse nuk dëshiron ta bëjë një gjë të tillë (ndoshta sepse çështjet politike me gjasë do të figurojnë dukshëm në hetim). Veç kësaj, komisionet mund t'i qepen komisionit të KLLP/raporteve të AGJ dhe/ose të ofrojnë këshilla në tema relevante. Kjo mund ta zgjerojë qasjen në Parlament për analiza të ekspertëve të pavarur. **Ajo që është e nevojshme është që KMFP të krijojë raporte të afërta me komisionet tjera funksionale dhe kryesore që janë përgjegjës për mbikëqyrje dhe vëzhgim të politikave specifike qeveritare në mënyrë që të kuptohet dhe mbështetet roli i tyre unik. Një memorandum mirëkuptimi është një metodë për arritjen e kësaj.**

	Komisioni funksional/kryesor	KMFP	Mbulimi
Interesi kryesor	Ku politikat qeveritare përkojnë me nevojat e vendit	Ku programet dhe shërbimet po japin vlerë për para	
Politika	Të interesuar rreth asaj nëse politika e tanishme është e përshtatshme apo nëse duhet eksploruar apo zhvilluar politika tjera.	Merr politikën e tanishme si pikënisje. Nuk merr në pyetje politikën por mund të ekzaminojë nëse analiza financiare e politikës përforcuese është kryer në mënyrë korrekte.	JO

Zbatimi i politikës	Të interesuar rreth asaj nëse politika e tanishme po prodhon rezultatet e dëshiruara apo nëse politika tjera do të ishin më efektive.	Të interesuar rreth asaj nëse programet dhe shërbimet po mbahen në pajtim me dëshirat e legjislaturës.	PO
Kostoja	Të interesuar në kosto në kushte të gjera për të ndihmuar në vlerësimin e opsioneve politike.	Të interesuar rreth asaj nëse programet dhe shërbimet mund të mbahen me kosto më të efektshme apo mund të arrihet më shumë me të njëjtën shumë të parave.	JO

D. Marrja përsipër e hetimeve

Një çështje e ngritur gjatë vizitës time ishte mungesa e marrëveshjes përbrenda KMFP rreth asaj se çfarë duhet të hetojë komisioni. Kjo është pjesërisht si pasojë e natyrës së lartë partiake në Kuvend dhe në komisionet e tij. **Në rast të mosmarrëveshjes, KMFP mund të dëshirojë të mësojë nga praktika e Ishullit Man dhe ta pyes vetën me këto pyetje para se ta kryejë një Hetim.**

- Rëndësia apo rëndësia potenciale e çështjes së reputacionit të Kuvendit apo Kosovës më gjerësisht;
- Kredibiliteti i ndonjë deklaratë për të cilën është kërkuar nga Komisioni që ta hetojë;
- *Quantum*; shuma e parasë të përfshirë; dhe
- Pyetja nëse kjo çështje mund t'i referohet një komisioni ekzistues në Kosovë.

Veç kësaj, duhet kërkuar këshilla e AGJ (Ishulli Man është në proces të themelimit të pozitës së AGJ).

E. Reagimi i Qeverisë ndaj raporteve të auditimit

Shumë nga palët e interesuara thanë se ky është një problem i vërtetë brenda Kosovës. Për t'i ndihmuar Kuvendit dhe KMFP-së, unë kam ofruar më poshtë disa shembuj nga përvoja në Ishujt Britanikë.


Pothuajse të gjithë KLLP-ët në Ishujt Britanikë kanë një kornizë kohore për përgjigjet nga ekzekutivi. Si Ishulli Man ashtu edhe Irlanda kërkojnë një përgjigje brenda tre (3) muajsh, përmes Ministrit të Financave. Korniza kohore në Uells është normalisht 6 javë, ndërsa përgjigja vjen përmes një portofol ministri përkatës. Manuali i Financave Publike në Skoci cakton një kornizë kohore prej 2 muajsh (e cila është e fuqizuar në mënyrë strikte) ndërsa përgjigjet bëhen përmes oficerit përgjegjës të departamentit përkatës.

Në Jersey, portofol ministri përkatës normalisht do të ofronte një përgjigje të detajuar për gjetjet dhe rekomandimet brenda 6 javësh nga publikimi i raportit. Nëse ekzekutivi është në gjendje vetëm të ofroj raport *të përkohshëm* brenda kësaj kornize kohore, një përgjigje plotë pritet të jepet brenda 3 muajsh. Departamenti i Financave dhe Personelit (DFP) iu përgjigjet të gjitha raporteve të KLLP në Irlandën Veriore në një formë të Memorandumit të Kundërpërgjigjes që i adresohet secilit përfundim dhe rekomandim të KLLP. Nuk është dhënë asnjë përgjigje në lidhje me kornizën kohore, por është normale që një studim dhe përgjigje e shpejtë e raportit të fundit të KLLP nga DFP të propozojë një kornizë kohore prej 3-4 muaj.

Në pothuajse 70 për qind të rasteve përgjatë Komonullthit, kryesuesit e KLLP deklaruan se qeveria reagon në mënyrë të favorshme ndaj rekomandimeve të Komisionit, ndërsa në 56 për qind të rasteve, qeveria gjithashtu zbaton ato rekomandime.²⁵ KLLP-ët në Ishujt Britanikë raportojnë sukses edhe më të madh: më shumë se 90 për qind e rekomandimeve nga KLLP-ët e Britanisë pranohen nga qeveria dhe të gjitha rekomandimet e KLLP-ëve të Uellsit ishin pranuar nga Asambleja e Përgjithshme e Uellsit nga shtatori i 2007 deri në dhjetor të 2008.

Pyetja e parë duhet shtruar është nëse nga ekzekutivi kërkohet të reagojë ndaj rekomandimeve të auditorit; pyetja tjetër për tu shtruar është nëse ekziston një sistem sistematik për të kontrolluar nëse janë zbatuar në të vërtetë rekomandimet. Virtualisht, çdo KLLP në Ishujt Britanikë kanë procese në vend për të monitoruar dhe për të përcjellë reagimet e qeverisë ndaj rekomandimeve të KLLP. Ekziston një përzierje e mekanizmave formal dhe joformal, ndërsa Uellsi ia le në dorë ZKA për t'i monitoruar reagimet qeveritare²⁶.

Kjo është ajo që njihet si “raportim i gjendjes” mbi progresin për t'i siguruar përmirësimet përmes procesit të llogaridhënies. Në Kosovë, AGJ raporton që organet e auditorit deri në një pikë kanë zbatuar një përqindje të ulët të rekomandimeve të dhëna dhe vjen në



përfundim se gatishmëria apo shkathhtësia për t'i pranuar këshillat e tyre është në një nivel të pamjaftueshëm.²⁷ Shpresohet se përmes themelimit të KMFP, ky do të asistojë në pranimin dhe zbatimin e gjetjeve të auditimit. Një hap i logjikshëm është që AGJ dhe KMFP të ndërmarrin një Hetim të vazhdueshëm mbi raportet e tyre duke u bazuar në auditimet e performansës. Në

²⁵ Stapenhurst et al. 2007 f.145.

²⁶ Në Botswana PAC ka opsionin e refuzimit të reagimeve të papërshtatshme nga departamentet qeveritare tek Komisioni i Ombudspersonit apo tek Prokurori Publik.

²⁷ Raporti Vjetor i Performansës 2009, f.8

Britani, për shembull, AGJ po i kthehet të gjitha rekomandimeve dhe minutave të Thesarit për tu siguruar që rekomandimet janë zbatuar. Në Kanada, departamentet janë të obliguara me ligj që t'i publikojnë planet e tyre për t'ju adresuar kritikave nga KLLP dhe AGJ. Në shumë vende, Raporti Vjetor i Departamenteve ka një sektor të veçantë mbi progresin e arritur në zbatimin e rekomandimeve dhe rezultateve të ndryshimeve të bëra. Në Ugandë, Sekretari i Thesarit duhet ta informojë Parlamentin brenda 40 ditësh mbi veprimet që janë marrë për secilin rekomandim. Nëse Parlamenti nuk është i kënaqur me sqarimet e pranuar, mund të bëjë rekomandime shtesë.

Një raport progresi i të gjitha rekomandimeve të pranuar gjatë seancës parlamentare ofrohet nga Manuali i Financave Publike në Skoci ndërsa KLLP mund të kërkojë raporte progresi dy herë gjatë seancës (seanca është në 4 vjet) apo të kërkojë të dhëna më të shpeshta nëse dëshiron. Në Irlandën Veriore ka monitorim të vazhdueshëm nga ZAIV, ndërsa KLLP përcjellë departamentin për një informim një vjet pas pranimit të reagimit. Në disa raste, komisionet statutores iu adresohen çështjeve që dalin nga rekomandimet e KLLP. Nëngrupet e caktuara të KLLP monitorojnë reagimet e qeverisë në Jersey, në disa raste përmes AG. Në Irlandë, AGJ mund të ekzaminojë zbatimin në auditimin e ardhshëm, por KLLP do të përcjellë me oficerin e llogaritjeve në paraqitjen e tij apo saj të ardhshme, ndërsa minuta e ministrit që tregon pranimin e rekomandimeve në përgjithësi do t'i lejonte KLLP që të vazhdojë me një pyetje në ekzaminimin e ardhshëm të atyre llogarive. Nuk ka mekanizma formale në Britani të Madhe, por ZKA prodhon komente në të gjitha reagimet e qeverisë. Veç kësaj, një sërë çështjesh (prokurimi i mbrojtjes, kreditë e taksave) shqyrtohen një herë në vit. Qeveria e Ishullit të Mani duhet ta paraqes një raport vendimi vjetor, i cili mund ta adaptohet. Në Guernsey, KLLP ndërmerr programin e tij përcjellës dhe i riviziton zonat e rishikuara. Në disa raste raporti përcjellës paraqitet në letër; në rastet tjera do të jetë një rishikim i plotë që çon në një debat në parlament.

Në Kosovë, me gjasë nuk mund të bëhet shumë për të siguruar se rekomandimet merren parasysh dhe zbatohen përderisa ekzekutivi detyrohet nga ligji apo përmes një kodi të praktikës për t'ju përgjigjur rekomandimeve të KMFP (edhe pse donatorët, shoqëritë civile dhe mediet i bëjnë presion qeverisë). Duhet të theksohet gjithashtu se fondet e ruajtura nga raportet e auditimit mund të inkurajojnë ekzekutivin të fillojë ra çmojë rolin e Parlamentit dhe të AGJ-së në luftimin e korrupsionit. Një masë tjetër për ta ngritur profilin e raporteve të auditimit dhe ta shtojë presionin mbi qeverinë është që në të vërtetë t'i përkushtohet kohë parlamentare për të diskutuar për to në seancë plenare.

Kuvendi i Kosovës duhet të pajtohet në një legjislacion apo kod të ushtrimit që kërkon nga qeveria t'i përgjigjet raporteve dhe rekomandimeve të KMFP (dhe komisioneve tjera) për tu siguruar që puna e tyre ka kuptim dhe prodhon rezultate.

Veç paraqitjes së raporteve të KMFP në Kuvend, duhet të ketë edhe një debat vjetor mbi punën e komisionit, ndoshta duke u bazuar në Raportin Vjetor (ky rekomandim është gjithashtu i aplikueshëm edhe për komisionet tjera të Kuvendit). Çështjet që adresohen në një raport tipik vjetor të KLLP në Ishujt Britanikë përfshihen edhe procedura e fuqi të KLLP, raporti me AGJ (ku është i përshtatshëm), komentet e kryesuesit, numri i takimeve të mbajtura, puna e mbuluar, puna e ardhshme, njerëzit e takuar, rezultatet e takimeve dhe raportet e prodhuara.

F. Matja e Performancës

KMFP-ja është një komision i ri, mirëpo do duhet të demonstrojë progres dhe të arritura gjatë viteve në vijim. Kjo është arsyeja pse një Raport Vjetor dhe Buletinët Informativ janë aq me

vlerë. Ekzistojnë krahasues të ndryshëm që janë identifikuar nga IBB²⁸ dhe organizata tjera ndërkombëtare të cilët mund të shfrytëzohen për të matur performancën e KLLP-së e cila do jetë relevante për KMFP-në në vitet në vijim dhe mund të shfrytëzohet si tregues për Raportin Vjetor.

1. Niveli i Aktiviteteve

- Për të matur ngjarjet dhe në çfarë mase përdoren burimet për veprimet e KLLP-së

KMFP-ja duhet të vlerësojë dhe raportojë masën në të cilën KMFP-ja azhuron Raportet e AP-së si dhe koston e dorëzimit të rezultateve (buxhetin e saj, kohën e shpenzuar nga stafi parlamentar dhe Anëtarët).

2. Niveli i Rezultateve

- Për të matur rezultatet që janë menjëherë të dukshme të punës së KLLP-së.

KMFP-ja duhet të vlerësojë dhe raportojë se sa të shpeshta janë raportet e saj si dhe numrin e rekomandimeve të pranuar, ndërmarrjen e veprimeve pasuese, nivelin në të cilin zbatimet janë të pranueshme dhe shkallën e debatit të gjerë parlamentar dhe mbulesës mediale.

3. Niveli i Rezultateve

- Për të matur përmirësimet e qëndrueshme në administratën publike si dhe pasojat e menduara të procesit të përgjegjësive së KMFP-së dhe rezultateve të saj.

Rezultatet me shpresë do të përfshijnë pajtueshmëri më të mirë me ligjin/rregulloret nga zyrtarët, efektshmëri dhe efikasitet të ngritur të programeve qeveritare, përmirësime në strukturat e kontrolluara financiare, rritje të dijenisë publike dhe përkrahje të programeve qeveritare, rritje të dijenisë legislative në lidhje me cilësinë e menaxhimit publik të programeve dhe burimeve; dhe një përmirësim të perceptimit të jashtëm të ndershmërisë financiare për audiencat vendase dhe ndërkombëtare.

Kutia 2: Përmbledhje e Matjeve Potenciale të Performancës për KMFP-në²⁹

- Numri dhe pjesëmarrja e takimeve dhe seancave dëgjimore
- Numri i raporteve të dorëzuara
- Puna aktuale e përfunduar (raportet e lëshuara) në krahasim me planet dhe buxhetin
- Kohët e raportimit
- Përqindja e rekomandimeve të pranuar
- Përqindja e rekomandimeve të zbatuara


²⁸ Prezantim nga Rick Stapenhurst në një Grup Studimor në Auditimin Parlamentar, Helsinki, Finlandë, 16 Maj 2010.

²⁹ Përshtatur nga KPMG-ja. 2005. “Komisioni Parlamentar për Llogari Publike: Një perspektive Australiane dhe e Zelandës së Re”, pp. 48–49.

- Numri i referimeve parlamentare
- Numri i gjetje të përsëritura
- Shuma e kursimeve të matshme në shpenzimet publike të arritura si rezultat direkt i kërkesave të KMFP-së
- Vetëdijesimi mbi raportet e KMFP-së
- Numri i paraqitjeve të pranuar në kërkesat e KMFP-së
- Kënaqësia e parlamentit dhe publikut me efikasitetin e KMFP-së.

G. Stafi dhe Ndërtesat e KMFP-së

Një ankesë e zakonshme e KLLP-së është se burimet mund të jenë një shtrëngim në performancë efektive. Kjo veçanërisht është e saktë në vendet në zhvillim dhe Parlamentet më të vogla. Në Kosovë, KMFP-ja ka dy njerëz që përkrahin punën e saj. Nëpunësja vepron më shumë si sekretare për komisionin apo kryesuesin e komisionit. Kohëve të fundit një person i dytë i është shtuar si staf për të ndihmuar komisionin në përgatitje për seancat dëgjimore publike dhe për të përgatitur raporte nga to. KMFP-ja ka në dispozicion të saj 10,000 EUR në vit për të zhvilluar aktivitetet e saj gjë që është e saktë nga të gjitha komisionet tjera funksionale të Kuvendit. Kjo shumë do dyfishohej në rast se KMFP-ja bëhet e klasifikuar si komisioni kryesor apo permanent (shih rekomandimet e lartpërmendura).



Kryesuesi aktual i KMFP-së është i mendimit se komisioni ka mungesë të burimeve dhe ka nevojë për një auditor apo kontabilist me përvojë. Ai gjithashtu theksoi se ka nevojë për më shumë Anëtarë me dijeni të thella në çështje të llogaridhënies

në komision³⁰ (ndonëse nuk është e pazakontë për Anëtarët që shërbejnë në KLLP të kenë mungesë të dijenisë së detajuar mbi çështjet e llogaridhënies, veçanërisht nëse kemi parasysh preokupimin e përgjithshëm mbi politikat të Anëtarëve). KMFP-ja gjithashtu ka përkrahjen e dy anëtarëve të stafit nga KIPRED. KIPRED gjithashtu ka sjellë edhe ekspertë tjerë për të ofruar

³⁰ Intervista me Haki Shatrin, Kryesues i KMFP-së, 24 Qershor 2010.

përkrahje profesionale për Komisionin dhe përkrahja nga Zyra e Punëve të Jashtme dhe Komonuelthit të Britanisë së Madhe i ka mundësuar KMFP-së të vizitojë Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar dhe të ZKA në Londër.

Ja vlen të krahasohet situata në Kuvendin e Kosovës me përvojën në Ishujt Britanik dhe më tutje. Një KLLP tipike në Ishujt Britanik ka (përafërsisht) dy apo tre anëtarë të stafit të cilët punojnë me orar të plotë, mirëpo rezultatet janë disi të ndryshme. Një anketë e IBB e kohëve të fundit mbi KLLP-të e Komonuelth tregon për një mesatare prej më pak se dy anëtarëve të stafit që janë profesionistë të cilët janë të angazhuar me orar të plotë.³¹ Megjithatë, duhet të theksohet se shumica e KLLP-vë kanë qasje, direkt apo indirekt, në burimet e Zyrës së Auditorit. Shumica e KLLP-vë në Ishujt Britanik raportojnë se stafi i tyre pranon trajnime më të gjëra në lidhje me zhvillimet/reformat në sektorin publik (Guernsey, Irlandë, Ishulli i Man, Irlanda Veriore, Mbretëria e Bashkuar dhe Uells). Një situatë e njëjtë nuk është në Jersey dhe Skoci, ku argumentohet se kualifikimi teknik mund të furnizohet nga AP-ja.

Për mendimin tim ekziston një përkrahje e mjaftueshme për KMFP-në në periudhën afatshkurtër përderisa KIPRED vazhdon me udhëzimin dhe asistencën për komisionin dhe ZAP-in zhvillon lidhjet e saj me komisionin përmes një oficeri ndërlidhës parlamentar dhe udhëzimeve. Megjithatë, përkrahja e KIPRED-it nuk duhet të jetë një zgjidhje afatgjate dhe ekziston një nevojë për parlamentin që të marrë pronësinë mbi komisionin në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Prandaj trajnimet janë kyçe – jo vetëm për Kryesuesin dhe Anëtarët por gjithashtu edhe për stafin e në veçanti për Nëpunësit.

Veç vizitave në Parlamente tjera (KMFP-ja vizitoi Parlamentin Britanik dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit në Janar të vitit 2010), ekzistojnë disa takime ndërkombëtare në këtë fushë kohë pas kohe. Kryesuesi dhe Nëpunësi morën pjesë në një Grup Studimor mbi Auditimin Parlamentar në Parlamentin e Finlandës në Maj të vitit 2010. Këto programe normalisht mund të qasen përmes kanaleve konvencionale diplomatike. Gjithashtu ekziston edhe një Program për Mësimin e Përforcimit Parlamentar online (<http://parliamentarystrengthening.org/index.html>), i përkrahur nga IBB dhe organizata tjera ndërkombëtare, i zhvilluar për stafin parlamentar në tërë botën, e cila përfshinë një modul mbi Parlamentin dhe Buxhetin. Interneti është një burim i vlefshëm dhe mund të shpërndajë informata mbi praktikat e KLLP-ve në juridiksionet tjera.

Kutia 3: Adresat e ueb faqeve të KLLP-vë në Ishujt Britanik

Britani e Madhe

<http://www.parliament.uk/business/committees/committees-archive/committee-of-public-accounts/>

Uells

<http://www.assemblywales.org/bus-home/bus-committees/bus-committees-other-committees/bus-committees-third-ac-home.htm>

Skoci

<http://www.scottish.parliament.uk/s3/committees/publicAudit/index.htm>

Shtetet e Gërni

<http://www.gov.gg/ccm/navigation/government/public-accounts-committee/>

Shtetet e Jersey

<http://www.scrutiny.gov.je/panel.asp?panelid=30>

³¹ Stapenhurst *et al.*, 2007 p. 155.

Irlandë Veriore

<http://www.niassembly.gov.uk/public/accounts.htm>

Irlandë

<http://www.oireachtas.ie/viewdoc.asp?fn=/documents/Committees30thDail/PAC/Homepage.htm>

KMFP-ja dhe KIPRED-i mund të dëshirojnë të hulumtojnë nëse mund të realizohet një delegacion prej KMFP-së (duke përfshirë Nëpunësen) që të marrin pjesë në shkollën verore që mbahet çdo vit për Komisionet parlamentare për llogari publike në Universitetin La Trobe në Australi nga 6-12 Shkurt 2011. Në këtë shkollë normalisht pjesëmarrja është deri në 45 anëtarë të komisionit për llogari publike dhe auditorë gjeneralë nga parlamentet Afrikane, Aziatike dhe të Paqësorit³². Kosto është A\$2250 (1550 EUR) për pjesëmarrës, plus biletat e aeroplanit dhe si pasojë një formë e sponsorizimit do të kërkohej.

Nëpunësi i KMFP-së gjithashtu mund të përfitojë nga një dërgim në KLLP-të e Parlamenteve tjera. Për mendimin tim legjislativat e Uells, Skoci, dhe Irlandën Veriore do të ishin vende të përshtatshme për të vizituar. Megjithatë, unë besoj se opsioni më i mirë në periudhën afatshkurtër do të ishte që të kërkohej asistencë nga një nëpunës me përvojë nga një legjislaturë tjetër që të vizitojë Kosovën dhe të veprojë si një këshilltar i nëpunësit aktual dhe kryesuesit për të mbikëqyrur periudhën prej inicimit të Kërkesës, planifikimit të Seancës Dëgjimore, udhëheqja e Seancës Dëgjimore, shkrimin e raportit. Kur të hetohen këto opsione, unë do sugjeroja që KMFP-ja dhe Parlamenti të përqendrohen në legjislativat më të vogla të Skocisë, Uellsit, Irlandës Veriore ose ndoshta Jersey ku të gjitha i kanë KLLP-të e themeluara gjatë 10-15 vitet e fundit.

Përfundimisht, është gjithashtu e qartë se ka nevojë për ngritje të kapaciteteve brenda Kuvendit në mënyrë që të rritet mundësia që Deputetët të kuptojnë rolin e KMFP-së dhe çështjeve më të gjëra të llogaridhënies. Mungesa e interesit nga ana e kryesuesve të komisionit dhe përfaqësuesve të komitetit drejtues të partive të marrin pjesë në një takim me mu këtë temë me 23 Qershor është udhëzuese. Kjo ngritje e kapaciteteve duhet të bëhet në fillim të Parlamentit tjetër (në formë të seminarit pas-zgjedhor) dhe të jetë i aranzhuar për të gjithë Anëtarët me fokus në përgjegjësitë e tyre si Anëtarë të Kuvendit më tepër se sa si përfaqësues të partisë politike.

³² Mund të ketë problem potencial gjuhësor që duhet të tejkalohet pasi që mendoj që të gjitha seancat janë në gjuhën Angleze dhe nuk ka përkthim.

IX. KONKLUZION: NDËRTIMI I KULTURËS SË LLOGARIDHËNIES

Zhvillimi i brendshëm institucional i KMFP-së ka qenë mjaft madhështor. Komisioni është bërë operacional me 2 nëntor 2009 dhe që nga ajo kohë ka mbajtur dy takime në muaj. Në shkurt të vitit 2010 KMFP-ja ka aprovuar Planin e saj vjetor të Punës dhe aktivitetet e saj janë aprovuar me 29 prill 2010 me amendamentimin e Rregullave të Procedurës për Kuvendin. Në maj KMFP-ja lëshoi Buletinin e parë Informativ dhe Komisioni aktualisht është i angazhuar në pajtimin mbi Rregullat e veta të Procedurës që rregullojnë organizimin e saj të brendshëm dhe mënyrën e punës.

Ky raport përmban disa rekomandime të mëtutjeshme për të forcuar punën dhe performancën e KMFP-së, si dhe të ZAP-it. KMFP-ja dhe ZAP-i kërkojnë burime të mëtutjeshme në mënyrë që të bëhen efektive. Në këtë fazë prioritet duhet ti jepet ZAP-it pasi që shkon në drejtim burimeve për auditime intensive të performancës dhe KMFP-ja mbështetet në ZAP-in për punën e tyre e cila duhet edhe të jetë e vazhdueshme dhe në 'bazë të nevojave'. Në të njëjtën kohë, KMFP-ja duhet të ketë besim në të gjeturat e auditimit dhe auditimi i performancës i ZAP-it do të, unë besoj, ndihmoj në ndërtimin e besimit në mes të KMFP-së dhe të ndihmojnë AP-në e tanishëm në përpjekjet e tij për reforma. Standardet etike të ZAP-it dhe KMFP-së duhet të jenë jashtë dyshimeve në krijimin e sistemit të zbatueshëm të qeverisjes së mirë.

Mandati dhe anëtarësia e KMFP-së dhe COB duhet të kontrollohen përsëri në mënyrë që të sigurohet status i barabartë dhe të parandalohet dublifikimi apo konkurrenca në mes të dy komisioneve. Gjithashtu duhet të ketë një vëmendje më të madhe në marrëdhëniet në mes të të gjitha komisioneve sektoriale (funksionale) dhe KMFP-së dhe COB-së. Është veçanërisht e rëndësishme që Kuvendi të paraqes një ndarje të qartë të përgjegjësisve në mes të komisioneve veçanërisht në lidhje me funksionimin, mbikëqyrjen dhe financimit të organizatave të pavarura.

Ndoshta, megjithatë, ka pasur shumë fokus në faktorët e brendshëm që ndikojnë në KMFP-në dhe OAF siç është kundërvënë tek ambienti i gjerë i llogaridhënies përmes së cilës të dy entitetet operojnë. Edhe strukturat më të avancuara të llogaridhënies financiare në botë do të vërtetojnë se ka pak përdorim praktik nëse nuk ekziston dëshira politike për të respektuar dhe përdorur strukturat politike qeverisëse të llogaridhënies si duhet.

Aktualisht ambienti i jashtëm nuk është i përqësueshëm për shqyrtimin e paanshëm financiar. Kjo pjesërisht është sepse strukturat llogaridhënëse shpesh janë të nënshtruara në nevojat e partive politike dhe gjithashtu është pjesërisht sepse ekzekutivi dominon në Kuvend. Por nuk është lehtë e qartë se palët e treta në shoqërinë Kosovare – nga qeveria, burokracia, Kuvendi, KMFP-ja, ZAP-i, mediat dhe shoqëria civile – janë të vetëdijshme mbi kërkesat dhe përgjegjësitë e llogaridhënies dhe të veprojnë në atë mënyrë që të mbështesin rezultatet të cilat janë të drejta, objektive dhe të parashikueshme. Për të dhënë një shembull, kur të vjen koha e emërimit të një AP-je nga brenda në Kosovë do të jetë shumë e vështirë, ndoshta e pamundur, që të gjendet dikush pa lidhje afatgjata me ndonjërin prej partive politike, kështu që mund të ketë akuza të influencës me ndonjë emërim të brendshëm të pozitës së AP-së.

Sidoqoftë një kulturë e llogaridhënies nuk mund të imponohet nga jashtë, ndonëse duhet të përkrahët nga komuniteti ndërkombëtar dhe donatorët. Kjo duhet të vijë prej brenda vetë Kosovës përderisa vazhdon procesin e demokratizimit dhe rrugën e cila me kohë mund të dërgoj në anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Kjo do të kërkojë leadership në pjesën e të gjithë politikanëve. Puna e ZAP-it dhe KMFP-së nuk është lojë e shumës zero. Ekziston një çmim i

llogaridhënies që qeveritë duhet ta paguajnë si shkëmbim për zyrë (McGee 2002), mirëpo në të njëjtën kohë auditimi publik ekziston për të ndihmuar qeveritë në përmbushjen e objektivave të tyre dhe të përmirësojnë dorëzimin dhe zbatimin e politikës publike. Kjo është në interes të publikut dhe të të gjitha partive politike. Anëtarët Opozitarë nuk duhet të përdorin apo të presin nga komuniteti që të sulmojë qeverinë apo të jenë kritik mbi politikat qeveritare. Ekzistojnë mjaft shumë mundësi tjera brenda Kuvendit për debat publik të partisë kundërshtare. Llogaridhënia financiare duhet të ushtrohet për të mirën e vendit dhe jo për të mirën e një partie politike apo të disa institucioneve.

Ka nevojë që të ketë një vlerësim më të mirë të ambientit të gjerë të qeverisjes së sektorit publik për ZAP-in dhe KMFP-në. Gjithashtu komuniteti ndërkombëtar, palët tjera të brendshme të interesit duhet të mbështesin përpjekjet e KMFP-së dhe ZAP-it duke mbajtur qeverinë llogaridhënëse. Përvoja nga vendet tjera tregon se mediat mund të vërtetohen si shumë me ndikim në veprimet e qeverisë dhe të zyrtarëve publik individual. Në të njëjtën kohë, Kuvendi i Kosovës dhe KMFP-ja duhet të mbërrijnë deri te mediat dhe shoqëria civile dhe të sigurohen se ato mbahen në një hap me takimet dhe hetimet e KMFP-së dhe të gjeturat e rëndësishme të auditimit. Raportet e ZAP-it dhe të KMFP-së do të përmbajnë disa detaje teknike, mirëpo duhet të kihet kujdes që të sigurohet që ato të shkruhen në formë të lexueshme për një audiencë më të gjerë. Me rritjen e kapacitetit të stafit mbështetës të komisionit edhe KMFP-së bëhet më vendosmërisht e themeluar brenda Kuvendit, Instituti KIPRED dhe akterët tjerë duhet të shpenzojnë më pak kohë në jetën teknike ditore të komisionit dhe të përqendrohet në çështjet me strategji më të gjerë të llogaridhënies brenda Kosovës.

Pyetja rrënjësore që duhet të bëhet është nëse parimet kyçe dhe vlerat e nevojshme për arritjen e sistemit të fortë të llogaridhënies horizontale ekzistojnë brenda Kosovës? Kjo do kërkonte një Kuvend të fortë si një qendër që punon pranë agjencive tjera ose “rojtaret kushtetues”³³ për të ndarë barrën e llogaridhënies. Kuvendi vetë nuk mund të sigurojë llogaridhënie përtej një game të gjerë të aktiviteteve të qeverisë dhe morisë së organeve të tjera të sektorit publik. Ekzistojnë një numër organesh në Kosovë të cilat janë të dizajnuara për të siguruar integritetin e ekzekutivit (shembujt përfshijnë ZAP-in, Ombudspersonin Parlamentar dhe Komisionin Anti-Korrupsion). Megjithatë, qëllimi i Kuvendit duhet të jetë ai që është i përshkruar diku tjetër si “i ulur në krye të strukturave të gjera të llogaridhënies në mënyrë që të siguroj kornizën për aktivitetet e tyre, publikoj ekzistencën e tyre dhe të përdorë informatat që ata sigurojnë për të sfiduar Ministrat.”³⁴ **Unë besoj se është një kërkesë urgjente për rishikim të rolit, funksionit, raportimit dhe financimit të të gjithë rojtarëve etik apo “institucioneve të pavarura” brenda Kosovës për të siguruar njëtrajtshmëri në strukturë, praktikë të mirë dhe korniza e kuptueshme është e goditur në mes të pavarësisë nga Ekzekutivi dhe llogaridhënies tek Parlamenti. Një raport i tillë duhet të vendoset dhe zbatohet para Zgjedhje të ardhshme të Përgjithshme.**

³³ Termi “rojtaret kushtetues” është përdorur si shkurtesë për “organet me fuqi të bindjes dhe publicitetit për të ndryshuar veprimet e ekzekutivit në fushat e karakterizuara si kushtetuese. Këto përfshijnë të drejtat e njeriut, çështjet elektorale, rregullimi i ofendimit dhe votimi i furnizimit. Gay, Oonagh (2005), “Time for Coherence: Parliament and the Constitutional Watchdogs” in P.Giddings (ed.) (2005) The Future of Parliament, Palgrave Macmillan.

³⁴ Raporti i Hansard Society Commission on Parliament Scrutiny. The Challenge for Parliament: Making Government Accountable, Vacher Dod Publishing Limited 2001 p.1

ANEKS A

Mandati i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike është komision funksional; fusha e punës së tij është:

- mbikëqyrja e ligjshmërisë së shpenzimeve të fondeve publike bazuar në auditin vjetor dhe raporteve periodike dhe deklaratave financiare si dhe të raporteve të auditit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;
- mbikëqyrje të të gjitha raporteve të auditit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike;
- mbikëqyrjen e raporteve të performancës të hartuara nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm;
- mbikëqyrja e raporteve të auditit dhe performancës së shpenzimeve financiare të hartuara nga institucionet që kryejnë mbikëqyrje të fondeve publike, agjencive publike, ndërmarrjeve publike dhe institucioneve publike të cilat pranojnë fonde nga buxheti i Republikës së Kosovës;
- mbikëqyrja e shpenzimeve publike përmes raporteve nga Njësia Qendrore Harmonizuese (NjQH) të cilat përmes Ministrit të Ekonomisë dhe Financave dorëzohen në Parlament dhe tek ky Komision;
- mbikëqyrja e shpenzimeve publike përmes raporteve nga organizatat buxhetore të hartuara me kërkesë të veçantë të Komisionit;
- rishikimi i raporteve vjetore të punës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;
- ndërmarrja e veprimeve në procedurën e përzgjedhjes së auditorit të jashtëm që do të kryej auditimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;
- rishikimi i kërkesave të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, të nevojshme për përmbushjen e detyrave të caktuara për të me ligj, dhe të japë rekomandime në këtë vështrim tek Komisioni për Buxhet dhe Financa;
- rishikimi i zbatimit të ligjeve brenda fushës së saj të punës;

Rishikimi i çështjeve tjetra të parapara me këtë Rregullore dhe detyra tjera të transferuara tek ky Komision me një vendim të veçantë të Kuvendit;

Mandati i Komisionit për Buxhet dhe Financa

Komisioni për Buxhet dhe Financa është komision permanent.

Komisioni brenda fushës së punës dhe përgjegjësi të tij duhet të rishikoj të gjitha çështjet lidhur me buxhetin dhe financat në Kosovë. Fusha e punës së këtij komisioni është:

- Rishikimi i Buxhetit vjetor të Kosovë dhe rishikimet e tij;
- Çështjet buxhetore dhe financiare;
- Implikimet buxhetore për vitin e parë dhe vitet në vijim të raportuara me projekt ligj dhe të japë rekomandime tek Komisioni i duhur Funkcional apo Kuvendi;
- Rishikon raportet periodike të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, mbi shpenzimet në institucionet Kosovare dhe organizatat buxhetore të cilat raportojnë në Kuvend;
- Raporton kohë pas kohe, me vetë iniciativë apo pas një kërkesë të Kuvendit, në një seancë plenare mbi çështjet që bien në fushën e saj të punës;
- Angazhohet në rishikimin e programit Qeveritar, mënyrën dhe nivelin e zbatimit të tij në fushën e financave dhe jep rekomandime tek Kuvendi;
- Mbikëqyr zbatimin e Ligjit mbi Menaxhimin dhe Përgjegjësitë e Financave Publike, si dhe ligjet tjera që merren me financat publike;
- Bashkëpunojë me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe Qeverinë, e cila është e obliguar që të sigurojë të gjitha informatat e kërkuara nga Komisioni, duke përfshirë raportet e ministrit dhe të të gjithë personave të autorizuar brenda ministrive;
- Rishikojë legjislacionin në fushat lidhur me buxhetin dhe financat;
- Të drejtën për të iniciuar dhe hartuar ligje;
- Rishikojë ligjet e hartuara dhe mocionet e pavarura në lidhje me kostos buxhetore, si dhe aktivitetet e përgjithshme të Kuvendit dhe institucioneve tjera lidhur me fushën e saj të punës;
- Komisioni gjithashtu ushtron detyra tjera të cilat i caktohen nga kjo Rregull e Procedurës.
- Rishikimi i çështjeve tjera të përshkruara nga Rregullat e Procedurës dhe çështje tjera të cilat, me vendim të veçantë të Kuvendit, transferohen tek ky Komision;

Në ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni bashkëpunon me linjën respektive të ministrive dhe ministritë tjera, nga të cilat mund të kërkojë informata konkrete, duke përfshirë raporte direkte nga ministrat apo personat tjera përgjegjës, nëse kjo kërkohet nga Komisioni.

BIBLIOGRAFIA

Kuvendi i Kosovës (2006) Rregullat e Procedurës së Kuvendit të Kosovës.

Auditi i Skocisë (2010) Raporti Vjetor 2009/10.

KPMG. 2005. “Komisioni Parlamentar i Llogarive Publike: Perspektiva nga Australia dhe Zelanda e Re.”

Giddings, Philip (ed.) (2005), *E ardhmja e Parlamentit*, Palgrave Macmillan

Hansard Society (2001), Raporti i Komisionit për Shqyrtime Parlamentare: Sfida për Parlamentin – Bërja e Qeverisë Llogaridhëuese, Londër: Vacher/Dod.

KIPRED (2010). Buletin Informativ, Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike.

McGee, David. 2002. *Mbikëqyrësit: Komisionet e Llogarive Publike dhe Shpenzimet Publike*. Asociacioni Parlamentar i Komonuelthit në bashkëpunim me Pluto Press. Londër: Pluto Press.

Milan Martin Cvikl (2008). *Mandati i ti Mundësi të reja*, OSBE, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Assessment_Report_English.pdf [qasur me 30 Qershor 2010]

Zyra e Auditorit Gjeneral (2010) Raporti Vjetor i Performancës 2009.

ODI (2008) Zgjerimi i llogaridhënieve në shfrytëzimin e resurseve të sektorit publik: Si të përmirësohet efektiviteti i Komisioneve të Llogarive Publike, Dokument Historiku për Konferencën Trejçeare për Auditorët Gjeneral të Komonuelthit 2008.

Staddon, A (2007) Mbajtja në llogari e ekzekutivit? Funkzioni i llogaridhënieve të parlamentit të MB, <http://siteresources.worldbank.org/PSGLP/Resources/HoldingtheExecuTheAccountabilityFunctionoftheUKParliament.pdf> [qasur me 27 qershor 2010]

Staddon, A (do të dal) Komisioni Parlamentar i Llogarive Publike: Perspektiva e Ishujve Britanik

Stapenhurst, F.R (2010) Parimet e Para të Auditit Parlamentar, një Punim i prezantuar në një Grup Studimor në Auditimin Parlamentar, Helsinki, Finlandë, 16 Maj 2010.

Stapenhurst, F., R. Pelizzo, and M. O'Brien. 2007. “Shqyrtimi i shpenzimeve publike: vlerësimi i performancës së Komisioneve të Llogarive Publike.” Në McGee, David, Procesi Buxhetor, një domosdoshmëri parlamentare. Londër: Pluto Press.

Venhari, A & Marmullakaj, Q (2009) Mbikëqyrja e Financave Publike në Kosovë, KIPRED, Prishtinë, Kosovë.

